


ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga
gjurmimi i të
diplomuarve
2018-2022



Ky raport është hartuar nga Jonida Jani nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).
Koordinator për gjurmimin në Shkollën “Salih Çeka”: Alda Palla

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)	6
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)	7
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)	8
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)	8
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2018-2022)	9
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2018-2022)	10
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)	10
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)	11
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2018-2022)	11
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2022)	12
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)	12
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022	14
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)(2018-2022)	15
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)	16
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)	16
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë punësimit me kohë të pjesshme (2018-2022)	17
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2018-2022)	17
Figura 18: Lloji i kontratës (2018-2022)	18
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2018-2022)	18
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)	19
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)	22
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)	22
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)	23
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)	23
Figura 25: Papunësia ndër vite (2018-2022)	24
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)	25
Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)	26
Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2018-2022)	27
Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)	28
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)	29
Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)	29

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit	6
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)	13
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2018-2022)	13
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2018-2022)	14
Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2018-2022)	19
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2018-2022)	20
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2018-2022)	20
Tabela 8: Ndhimja e shkollës në gjetjen e punës së parë (2018-2022)	21
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)	24
Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2018-2022)	25
Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)	26
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2018-2022)	27
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)	28
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2018-2022)	30

Tabela e përmbajtjes


1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?	5
2. Të diplomuarit 2018-2022	6
3. Analiza e rezultateve.....	8
3.1 Statusi i punësimit.....	8
3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit	11
3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës	13
3.4 Niveli i pagave.....	14
3.5 Kushtet e punës	16
3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....	18
3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....	19
3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë.....	20
3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme	21
3.10 Të diplomuarit pa punë.....	24
3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë	27
3.12 Planet për të ardhmen	30
4 Përfundime	30

1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla “**Salih Çeka**”, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i

maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **pesë brezave me të diplomuar** të shkollës “Salih Çeka”.

2. Të diplomuarit 2018-2022


Në vitin shkollor 2021-2022, në shkollën “Salih Çeka”, u diplomuan 116 nxënës (shiko tabelën 1), 16 nxënës më shumë sesa gjatë vitit 2020-2021.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2017-2018	159	97	61%
2018-2019	139	100	72%
2019-2020	147	121	82%
2020-2021	100	84	84%
2021-2022	116	98	84%

Nga të diplomuarit e vitit 2021-2022 u gjurmuan 98 nxënës ose 84% e të diplomuarve. Shumica e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë mashkullore 86% (N=84) dhe 14% (N=14) gjinisë femërore (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=98

Ndërsa të shpërndarë sipas drejtimeve (shiko figurën 2), përqindjen më të lartë të të gjurmuarve e kanë të diplomuarit e drejtimit Hoteleri-Turizëm me 47% dhe më të ulët in ata të drejtimit Ekonomi-Biznes me 5%.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=98

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 79% e të diplomuarve janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri, dhe 21% (N=21) jashtë vendit (shiko figurën 2). Mesatarisht për vitet 2020-2021, 81% e të diplomuarve jetojnë në Shqipëri dhe 19% jetojnë jashtë vendit një vit pas diplomimit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=121); 2021 (N=84); 2022 (N=98)


Nga të diplomuarit që jetojnë jashtë vendit, 5 (pesë) jetojnë në Greqi, 4 (katër) në Angli, 4 (katër) në Gjermani, 4 (katër) në Itali dhe 2 (dy) në Maqedoni. Ndërkohë, në Maltë dhe Belgjikë jeton përkatësisht nga 1 (një) i diplomuar në secilin shtet.

3. Analiza e rezultateve

3.1 Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022), nga një total prej 98 të anketuarish 52% (N=51) ishin të punësuar, 13% (N=13) ishin të vetëpunësuar, 17% (N=17) ishin student/kursant dhe 8% (N=8) ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 9% (N=9) të diplomuar një vit pas diplomimit.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=98

Referuar figurës 5, në vitin 2022, 73% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Viti 2022 shënon një rritje të punësimit me 6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021. Mesatarja e punësimit për të pestë brezat e gjurmuar është 55%. Viti 2019 ka shënuar shkallën më të ulët të punësimit me 31%. Ndërkohë, 9% e të diplomuarve në vitin 2022, janë të papunë. Papunësia këtë vit shënon vlerën më të ulët ndër vite. Mesatarisht, për vitet 2018-2021, 20% e të diplomuarve kanë qenë të papunë një vit pas diplomimit. Si rezultat, për vitin 2022 kemi një ulje të papunësisë me 11 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021. Ndërkohë, 17% e të diplomuarve të vitit 2022 janë student/kursant. Mesatarisht, në vitet 2018-2021, 27% e të diplomuarve kanë qenë student/kursant. Pra, kemi një ulje me 10 pikë përqindje të atyre që vijojnë studimet e mëtejshme për vitin 2022 në raport me mesataren e viteve 2018-2021.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=97); 2019 (N=100); 2020 (N=121); 2021 (N=84); 2022 (N=98).

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2022, 52% e të diplomuarve janë të punësuar dhe 13% të vetëpunësuar (shiko figurën 6). Vërehet një rritje me 15 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (37%) e punësimit në raport me vetëpunësimin. Ndërkohë, mesatarja e vetëpunësimit në vitet 2018-2021 ka qenë 10%. Si rezultat, në vitin 2022 kemi një rritje të vetëpunësimit me 3 pikë përqindje.


Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=97); 2019 (N=100); 2020 (N=121); 2021 (N=84); 2022 (N=98)

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 83% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 80% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 63% e të diplomuarve në TIK dhe 20% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Për më tepër, vërehet se 60% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 30% e të diplomuarve në TIK vijojnë studime të mëtejshme.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** EB (N=5); HT (N=46); T (N=20); TIK (N=27)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 36% e vajzave të diplomuara janë të punësuar, 36% studente/kursante dhe 29% të papuna. Ndërkohë, 80% e djemve të diplomuar janë të punësuar, 14% student/kursant dhe 6% të papunë. Për të dy gjinitë vihet re se numri i të diplomuarve që janë student/kursant është më i lartë sesa numri i të papunëve.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=84); F (N=14).

3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 69% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, ndërsa 31% u shprehën që nuk lidhet. Nga viti 2018-2021 (shiko figurën 9), mesatarisht 69% e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe 31% se puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit.


Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=41); 2019 (N=31); 2020 (N=77); 2021 (N=56); 2022 (N=72)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 10), vërehet se mesatarisht (2020-2022) 89% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 90% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 72% e të diplomuarve në Termohidraulikë janë të punësuar në profesion. Ndërkohë, vetëm 40% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione dhe 48% e të diplomuarve në TIK janë të punësuar në profesion.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2020:** N_{EB}=6; N_{HT}=36; N_T=16; N_{TK}=5; N_{TIK}=14; **Baza 2021:** N_{EB}=1; N_{HT}=27; N_T=18; N_{TK}=1; N_{TIK}=9; **Baza 2022:** N_{EB}=1; N_{HT}=38; N_T=16; N_{TK}=17

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 67% (N=45) e të diplomuarve të gjinisë mashkullore punojnë në profesion dhe 33% (N=22) nuk punojnë në profesion. Ndërkohë, 100% (N=5) e të diplomuarave të gjinisë femërore punojnë në profesion.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=67); F (N=5)

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e brezit 2021-2022 japin dy arsye kryesore: (i) pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (44% në 2022, mesatarja (2018-2021) 63%), si dhe (ii) paga/kushtet më të mira të punës aktuale (38% në 2022, mesatarja (2018-2021) 21%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	73%	75%	55%	50%	44%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	7%	13%	9%	20%	13%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	7%	0%	9%	0%	6%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	13%	13%	27%	30%	38%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=15); 2019 (N=8); 2020 (N=11); 2021 (N=10); 2022 (N=16)

3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në 2022 tregojnë se njohuritë përdoren “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 60% e të gjurmuarve. Mesatarisht, 59% e të diplomuarve në vitet 2018-2021 kanë pohuar se i përdorin “shumë/jashtëzakonisht shumë” njohuritë e fituara në shkollë.

Ndërkohë, 10% e të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2018-2021 ka qenë 19%. Pra, kemi ndër vite një ulje me 9 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara në shkollë në vendin e punës. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin “disi” për vitin 2022 është 18%. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2018-2021 ka qenë 17%. Pra, kemi një rritje me 1 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët pohojnë që i përdorin disi njohuritë e fituara në shkollë.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2018-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2018	32%	2%	20%	7%	39%
Të diplomuar në 2019	29%	7%	21%	7%	36%
Të diplomuar në 2020	4%	12%	22%	23%	39%
Të diplomuar në 2021	11%	5%	4%	14%	66%
Të diplomuar në 2022	10%	13%	18%	17%	43%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=41); 2019 (N=42); 2020 (N=77), 2021 (N=56); 2022 (N=72)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 57% e të diplomuarve në vitin 2022 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nga ana tjetër, 51% e vlerësojnë me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Mesatarisht, 57% e të diplomuarve në vitet 2018-2021 e vlerësojnë

lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve “shumë/jashtëzakonisht shumë” dhe 44% me “pak/aspak”.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2018-2022)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2018	37%	5%	17%	10%	32%
Të diplomuar në 2019	37%	10%	14%	12%	33%
Të diplomuar në 2020	37%	8%	23%	23%	39%
Të diplomuar në 2021	37%	4%	4%	14%	64%
Të diplomuar në 2022	37%	14%	19%	17%	40%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=41); 2019 (N=42); 2020 (N=77); 2021 (N=56); 2022 (N=72)

3.4 Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2022 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 6% paga minimale – 35,000 lekë, 17% në fashën 35,001 – 50,000 lekë, 25% në fashën 50,001 – 65,000 lekë, 19% në fashën 65,001 – 80,000 lekë dhe 33% paguhen më shumë se 80,001 lekë.

Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=72

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 13), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Për vitin 2022 askush nga të diplomuarit e gjurmuar nuk merr një pagë më të ulët se paga minimale, ndërkohë mesatarja e viteve 2018-2021 ka qenë 11%. Ndërkohë, përqindja e të diplomuarve të gjurmuar që marrin një pagë më të ulët se 35.000 lekë është ulur me 34 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (40% mesatarja, 6% në 2022). Gjithashtu, është ulur me 7 pikë përqindje mesatarja e të diplomuarve që marrin një pagë 35,001 - 50,000 lekë. (24% mesatarja 2018-2021, 17% në 2022). Ndërkohë, është rritur me 14 pikë përqindje mesatarja e të diplomuarve që marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë (11% mesatarja 2018-2021, 25% në 2022). Gjithashtu, është

rritur me 12 pikë përqindje numri i të diplomuarve që marrin një pagë 65,001 – 80,000 lekë (7% mesatarja 2018-2021, 19% në 2022). Rritjen më të madhe e ka numri i të diplomuarve që marrin më shumë se 80,000 lekë (33% në 2022), me 26 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (7%).


Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net)(2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=41); 2019 (N=31); 2020 (N=77); 2021 (N=56); 2022 (N=72)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se përkatësisht 3% (N=1) e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 18% (N=3) e të diplomuarve në TIK paguhen më pak 35,000 lekë. Ndërkohë, 11% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 13% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 35% e të diplomuarve në TIK paguhen mes 35,001 dhe 50,000 lekë. Gjithashtu, 100% (N=1) e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 29% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 19% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 18% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë 50,001 - 65,000 lekë. Nga ana tjetër, vetëm 26% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 25% e të diplomuarve në Termohidraulikë paguhen 65,001 – 80,000 lekë. Ndërkohë, 32% (N=12) e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 44% (N=7) e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 29% (N=5) e të diplomuarve në TIK paguhen më shumë se 80,001 lekë.


Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N_{EB}=1; N_{HT}=38; N_T=16; N_{TIK}=17

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 15), shohim se 100% (N=5) e vajzave të diplomuara marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë. Ndërkohë, 6% (N=4) e djemve të diplomuar marrin një pagë më të vogël se 35,000 lekë, 18% (N=12) marrin 35,001 - 50,000 lekë, 19% (N=13) marrin 50,001 – 65,000 lekë, 21% (N=14) marrin 65,001 – 80,000 lekë. Më shumë se 80,001 lekë marrin 36% (N=24) e djemve të diplomuar.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** M (N=67); F (N=5).

3.5 Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të pestë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Mesatarisht, 77% e të diplomuarve (2018-2022), punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 14% e të diplomuarve (2018-2021), punojnë me kohë të pjesshme dhe 9% me kohë të plotë sezonale.


Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë punësimit me kohë të pjesshme (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=31); 2019 (N=20); 2020 (N=66); 2021 (N=47); 2022 (N=59)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve (2022) vërehet se 66% e të diplomuarve punojnë në kompani me 5-9 punonjës, 25% në kompani me 1-4 punonjës, 7% në kompani me 10-49 punonjës dhe vetëm 2% (N=1) në kompani me më shumë se 50 punonjës. Mesatarisht, nga viti 2018-2021, 8% e të diplomuarve janë punësuar në kompani me mbi 50 punonjës, 17% në kompani me 10-49 punonjës, 46% në kompani me 5-9 punonjës dhe 29% në kompani me 1-4 punonjës.

Figura 17: Madhësia e kompanisë (2018-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=31); 2019 (N=20); 2020 (N=66); 2021 (N=47); 2022 (N=59)

Në vitin 2022, 76% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku, 54% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 22% me afat të caktuar. Ndërkohë, 24% nuk kanë një kontratë pune. Ndonëse numri i këtyre të fundit mbetet i lartë, vërehet një

përmirësim me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021, ku 29% e të diplomuarve nuk kishin një kontratë pune me punëdhënësin.


Figura 18: Lloji i kontratës (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=31); 2019 (N=20); 2020 (N=66); 2021 (N=47); 2022 (N=59)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të pesë brezave, 75% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Ndërkohë, mesatarisht 10% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe 15% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=31); 2019 (N=20); 2020 (N=66); 2021 (N=47); 2022 (N=59)

3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 83% e të diplomuarve në vitin 2022, u shprehën se ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” (shiko tabelën 5). Përkatësisht, 29% e të diplomuarve në vitin 2022 janë shprehur se ndjehen “shumë të sigurt” në vendin e punës,

me një rritje me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (24%). Ndërkohë, për të katërtin vit radhazi, asnjë nga të diplomuarit e gjurmuar nuk është shprehur se ndjehet “shumë i/e pasigurt”.

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 79% e të diplomuarve në vitin 2022 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe asnjë nuk shprehet “shumë i/e pakënaqur”. Sikurse e tregon edhe tabela 5, vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
<i>Shumë i/e pasigurt</i>	3%	0%	0%	0%	0%
<i>I/e pasigurt</i>	0%	5%	3%	2%	0%
<i>Neutral</i>	16%	30%	17%	19%	17%
<i>I/e sigurt</i>	65%	45%	48%	49%	54%
<i>Shumë i/e sigurt</i>	16%	20%	32%	30%	29%
<i>Shumë i/e pakënaqur</i>	0%	5%	3%	0%	0%
<i>I/e pakënaqur</i>	3%	0%	3%	0%	0%
<i>Neutral</i>	10%	35%	11%	19%	20%
<i>I/e kënaqur</i>	74%	40%	47%	64%	47%
<i>Shumë i/e kënaqur</i>	13%	20%	36%	17%	32%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=31); 2019 (N=20); 2020 (N=66); 2021 (N=47); 2022 (N=59)

3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 75% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit, 3% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 12% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit dhe 7% janë punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit. Vetëm 3% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 6 - 9 muaj pas diplomimit.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=60

Në një vështirm krahasues me vitet e mëparshme (shiko tabelën 6), mesatarisht 62% e të diplomuarve 2018-2021 kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit. Në këtë aspekt kemi një rritje me 13 pikë përqindje për vitin 2022 ku 75% e të diplomuarve arritën të gjejnë një punë para diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 10% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit (2018-2021). Në këtë kategori kemi një ndryshim me 7 pikë përqindje për vitin 2022 ku 3% e të diplomuarve gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit. Ndryshim me 4 pikë përqindje vërehet në kategorinë e atyre që e gjejnë punën 1 – 3 muaj pas diplomimit (12% 2022, 16% mesatarja e viteve 2018-2021).

Ndërkohë, ka ndryshuar me 3 pikë përqindje numri i të diplomuarve që gjejnë punë 3 - 6 muaj pas diplomimit (7% në 2022, përkundrejt 4% (mesatarja) në vitet 2016-2021). Vlen të theksohet se përqindja e atyre që gjejnë punë 9 – 12 muaj pas diplomimit mbetet zero për të dytin vit radhazi.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	53%	48%	58%	87%	75%
1 muaj pas diplomimit	8%	16%	14%	0%	3%
1 - 3 muaj pas diplomimit	29%	19%	11%	4%	12%
3 - 6 muaj pas diplomimit	3%	0%	11%	4%	7%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0%	10%	5%	4%	3%
9 - 12 muaj pas diplomimit	8%	6%	1%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=38); 2019 (N=31); 2020 (N=76); 2021 (N=47); 2022 (N=60)

3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të pestë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht 47% e të diplomuarve gjatë viteve 2018-2021 kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale. Për të diplomuarit e vitit 2022 kjo përqindje është 43%, duke shënuar një ulje me 4 pikë përqindje për këtë kategori.

Mënyrë tjetër për gjetjen e punës së parë është praktika profesionale në biznes. Mesatarisht, 26% e të diplomuarve gjatë viteve 2018-2021 e kanë gjetur punën e parë falë praktikës profesionale në biznes. Vërehet një ulje me 6 pikë përqindje në këtë kategori për vitin 2022, ku 20% e të diplomuarve janë shprehur se e kanë gjetur punën e parë falë praktikës profesionale në biznes.

Ndërkohë, mesatarisht gjatë viteve 2018-2021, 11% e të diplomuarve e kanë gjetur punën e parë nga mësuesit. Ndërsa në vitin 2022, 13% e të diplomuarve e kanë gjetur punën nga mësuesit. Për më tepër, 9% e të diplomuarve gjatë viteve 2018-2021 e kanë gjetur punën duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me punëdhënësit. Ndërkohë, 12% e të diplomuarve në vitin 2022 e kanë gjetur punën duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me punëdhënësit.

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	11%	6%	4%	0%	8%

Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	53%	68%	34%	32%	43%
Nga praktika profesionale në biznes	24%	16%	28%	36%	20%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	11%	3%	12%	9%	12%
Nga mësuesit	3%	0%	17%	23%	13%
Nga Zyra e Punësimit	0%	0%	3%	0%	0%
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	3%	0%	0%	2%
Tjetër	0%	3%	3%	0%	2%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=38); 2019 (N=31); 2020 (N=76); 2021 (N=47); 2022 (N=60)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2022, 53% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (rritje me 3 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (50%)); 50% pohuan se i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (ulje me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (56%)). Gjithashtu, mbetet i lartë numri i atyre që pohojnë se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar me gjetjen e punës së parë. Kështu, në vitin 2022, 24% (N=17) e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar. Në këtë aspekt kemi një rritje me 4 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (20%).

Tabela 8: Ndhurma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	39%	43%	47%	70%	53%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	44%	43%	57%	79%	50%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënësit potencialë	10%	12%	36%	59%	26%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	37%	24%	14%	7%	24%
Tjetër	0%	5%	5%	2%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=41); 2019 (N=42); 2020 (N=77); 2021 (N=56); 2022 (N=72)

3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2022, vetëm 8% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë. Kjo mesatare për vitet 2018-2021 ka qenë 4%. Në këtë aspekt kemi një rritje me 4 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë. Ndërkohë, 17% e të diplomuarve të gjurmuar për vitin 2022 shprehen se janë student/kursant. Këtu vërehet një ulje me 10 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 e cila ka qenë 27%.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=97); 2019 (N=100); 2020 (N=121); 2021 (N=84); 2022 (N=98)

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2022 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin 80% (20 nga 25 të gjurmuar). Ndërkohë, 16% (4 nga 25), studiojnë pranë një shkolle profesionale pas të mesmes.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=40); 2019 (N=38); 2020 (N=34); 2021 (N=14); 2022 (N=25)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 84% (N=21) studiojnë në institucione publike dhe 16% (N=4) në ato private. Në dy vitet e mëparshme (2022-2021), mesatarja ka qenë 96% në institucione publike dhe 4% në ato private. Pra vërehet një ndryshim me 12 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2020-2022 lidhur me llojin e institucionit ku të diplomuarit vijnë studimet e mëtejshme, me një favorizim të institucioneve private për vitin 2022.


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=34); 2021 (N=14); 2022 (N=25)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 80% (20 nga 25) e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 20% (5 nga 25) të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Nga viti 2020 deri në 2022 mesatarisht 62% e të gjurmuarve u shprehën se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 38% të cilët pohojnë se nuk lidhen.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=34); 2021 (N=14); 2022 (N=25)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 44% e të diplomuarve në vitin 2022 janë përgjigjur: për të fituar një kualifikim më të lartë (43% mesatarja e vitetve 2018-2021); 36% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (41% mesatarja e vitetve 2018-2021); dhe 8% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (14% mesatarja e vitetve 2018-2021). Ndërkohë, një i/e diplomuar (4%), ndjek kualifikime të mëtejshme pasi nuk po gjente dot punë.

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	40%	33%	47%	50%	44%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	53%	47%	35%	29%	36%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	3%	19%	12%	21%	8%
Nuk po gjeja dot punë	0%	0%	6%	0%	4%
Tjetër	5%	0%	0%	0%	8%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=40); 2019 (N=36); 2020 (N=34); 2021 (N=14); 2022 (N=25)

3.10 Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2022 është 9% (N=9), me një ulje me 11 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (20%).


Figura 25: Papunësia ndër vite (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=97); 2019 (N=100); 2020 (N=121); 2021 (N=84); 2022 (N=98)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 6 nga 9 të diplomuarit e papunë të vitit 2022 u përgjigjën që po. E shprehur në përqindje, 67% e të diplomuarve të papunë janë në kërkim të një pune. Një vit më parë, 9 nga 17 të diplomuarit e papunë janë shprehur se ishin në kërkim të një pune.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=21); 2021 (N=17); 2022 (N=9)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: mungesa e eksperiencës në punë (33% në 2022, 13% në vitet 2018-2021), mungesa e ofertës së punës në qarkun ku banojnë (33% në 2022, 15% në vitet 2018-2021), mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura për të gjetur një punë (17% në vitin 2022, 16% në vitet 2018-2021). Një arsye tjetër që japin të diplomuarit e gjurmuar është edhe angazhimi në punë familjare (17% në 2020, 11% në 2018-2021).


Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	8%	3%	19%	22%	33%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	0%	7%	6%	0%	0%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	23%	10%	19%	0%	0%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	8%	3%	19%	33%	17%
Nuk ka punë në qarkun tim	8%	13%	19%	22%	33%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	23%	17%	6%	0%	17%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-	0%	27%	0%	0%	0%
Nuk di si të kërkoj për punë	0%	0%	0%	11%	0%
Tjetër	31%	20%	13%	11%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=13); 2019 (N=30); 2020 (N=16); 2021 (N=9); 2022 (N=6)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), 83% e të diplomuarve në vitin 2022 japin si metodë kryesore njohjet, lidhjet familjare, miqtë dhe të njohurit. Kjo është metoda mbizotëruese e kërkimit të një punë edhe gjatë viteve 2020-2021 (64%). Gjithashtu, 33% e të diplomuarve pohojnë se gjejnë punë nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta etj, si dhe 33% duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me bizneset (duke dërguar CV etj.).

Figura 27: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=16); 2021 (N=9); 2022 (N=6)

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (shiko tabelën 11), 1 nga 3 të diplomuarit e papunë (33%) në vitin 2022 u shprehën se kishin në plan të largoheshin nga vendi. Një vit më parë, asnjë nga të diplomuarit e papunë nuk kishte në plan të largohet nga vendi. Ndërkohë, 1 nga 3 të diplomuarit e papunë (33%), janë shprehur se po pret të fillojë punë së shpejti. Një vit më parë (2021), 2 nga 8 të diplomuarit e papunë u shprehën se po prisnin të fillonin punë së shpejti. Për më tepër, 1 (një) i diplomuar është shprehur se kujdeset për fëmijët/familjen. Në vitin 2020, 2 nga 5 të diplomuarit e papunë u shprehën se kujdeseshin për fëmijët/familjen, ndërsa në vitin 2021, 3 nga 8 të diplomuarit e papunë kujdeseshin për familjen.


Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)

	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Po pres të filloj punë së shpejti	0%	25%	33%
Nuk kam besim se do gjej një punë	0%	13%	0%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	20%	25%	0%
Kam në plan të largohem nga vendi	20%	0%	33%
Kujdesem për fëmijët/familjen	40%	38%	33%
Tjetër	20%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=5); 2021 (N=8); 2022 (N=3)

Sikurse e tregon edhe figura 28, niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune më parë është ulur nga viti 2018 (54%) deri në vitin 2021 (0%), dhe u rrit sërish në vitin 2022 me 11%. Mesatarisht, nga viti 2018 deri në vitin 2022, 30% e të diplomuarve të papunë kanë qenë më herët në marrëdhënie pune.

Figura 28: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=13); 2019 (N=30); 2020 (N=21); 2021 (N=17); 2022 (N=9)

3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim. Theksi këtë vit është tek nevoja për përmirësimin e bashkëpunimit me zyrat e punësimit (57%), me një ulje me 6 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2018-2021 (63%), si dhe tek nevoja për përmirësim të kurrikulave, (47%), me një ulje me 9 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2018-2021 (56%). Për më tepër, kërkohet të përmirësohen tekstet dhe materialet (46%), bashkëpunimi me bizneset (45%) dhe këshillimi i karrierës (42%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Infrastruktura	73%	62%	55%	38%	32%
Kurrikula	66%	62%	46%	51%	47%
Tekstet dhe materialet	68%	50%	57%	54%	46%
Metodat e mësimdhënies	24%	33%	41%	24%	33%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	15%	29%	36%	14%	26%
Praktika në shkollë	29%	40%	50%	20%	31%
Praktika në biznes	32%	38%	58%	28%	35%
Këshillimi i karrierës	59%	62%	57%	36%	42%
Bashkëpunimi me bizneset	78%	60%	59%	35%	45%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	76%	60%	63%	53%	57%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=41); 2019 (N=42); 2020 (N=121); 2021 (N=75); 2022 (N=95)

Nëse do të kishin mundësi, 93% e të diplomuarve në vitin 2022 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 99% të njëjtën shkollë (shiko figurën 29). Mesatarisht, nga viti 2018-2022, 92% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë, dhe 94% të njëjtën shkollë.

Figura 29 Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shumica e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=97); 2019 (N=100); 2020 (N=121); 2021 (N=84); 2022 (N=98)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Për vitin 2022, 100% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, Hoteleri-Turizëm dhe Termohidraulikë, si dhe 96% e të diplomuarve në TIK do të zgjidhnin të njëjtën shkollë. Ndërkohë, 100% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 96% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 90% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 89% e të diplomuarve në TIK do të përzgjidhnin të njëjtën degë.

Mesatarisht nga viti 2019-2021, 100% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 95% do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Ndërkohë, mesatarisht nga viti 2018-2021, 94% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 85% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 91% e të diplomuarve në TIK do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Nga ana tjetër, 94% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 90% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 91% e të diplomuarve në TIK do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Të diplomuarit në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën dhe të njëjtën shkollë në masën 100%.

Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)


		Ekonomi-Biznes	Hoteleri-Turizëm	Termohidraulikë	Ndërtim	Tekstio-Konfeksione	TIK
Të diplomuar në 2018	Degë		89%	67%	89%	100%	96%
	Shkollë		92%	92%	100%	100%	92%
Të diplomuar në 2019	Degë	100%	96%	92%	83%		77%
	Shkollë	100%	100%	100%	100%		73%
Të diplomuar në 2020	Degë	85%	90%	92%		100%	100%
	Shkollë	85%	88%	77%		100%	100%
Të diplomuar në 2021	Degë	100%	100%	90%		100%	92%
	Shkollë	100%	98%	90%		100%	100%
	Degë	100%	96%	90%			89%

Të diplomuar në 2022	Shkollë	100%	100%	100%			96%
----------------------	---------	------	------	------	--	--	-----

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018:** N_{HT}=38; N_T=12; N_N=9; N_{TK}=12; N_{TIK}=26; **Baza 2019:** N_{EB}=16, N_{HT}=27; N_T=25; N_N=6; N_{TIK}=26; **Baza 2020:** N_{EB}=13; N_{HT}=48; N_T=26; N_{TK}=14; N_{TIK}=20; **Baza 2021:** N_{EB}=5, N_{HT}=44; N_T=20; N_{TK}=3; N_{TIK}=12; **Baza 2022:** N_{EB}=5, N_{HT}=46; N_T=20; N_{TIK}=27;

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi jepet në figurën 30. Sikurse vihet re, për vitin 2022, 92% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 100% e të diplomuarve të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Mesatarisht, nga viti 2018 në vitin 2021, 91% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 96% e të diplomuarve të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë.


Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=70); 2019 (N=78); 2020 (N=85); 2021 (N=61); 2022 (N=84); **Baza F:** 2018 (N=27); 2019 (N=22); 2020 (N=36); 2021 (N=23); 2022 (N=14)

Ndërkohë, përzgjedhja e së njëjtës shkollë e disagreguar sipas gjinisë jepet në figurën 31. Për vitin 2022, 99% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 100% e të diplomuarve të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Mesatarisht, nga viti 2018 në vitin 2021, 91% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 97% e të diplomuarve të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.

Figura 31: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M:** 2018 (N=70); 2019 (N=78); 2020 (N=85); 2021 (N=61); 2022 (N=84); **Baza F:** 2018 (N=27); 2019 (N=22); 2020 (N=36); 2021 (N=23); 2022 (N=14)

3.12 Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), 38% e të diplomuarve në vitin 2022 shpresojnë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje për vitin 2022 kanë shënuar një rritje me 6 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (32%). Ndërkohë, 36% e të diplomuarve në vitin 2022 pohojnë se kanë dëshirë të emigrojnë jashtë vendit, me një rritje me 11 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (25%). Për më tepër, 28% e të diplomuarve kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, me një ulje me 4 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (32%). Dëshira për migrim të brendshëm vijon të mbetet e ulët (1%).

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Të jem punësuar	23%	25%	19%	19%	10%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	35%	35%	27%	31%	28%
Të kem filluar biznesin tim	21%	25%	41%	43%	38%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	6%	4%	13%	15%	7%
Të kem emigruar jashtë vendit	24%	34%	21%	23%	36%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	1%	1%	2%	1%	0%
Tjetër	3%	2%	6%	4%	1%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=97); 2019 (N=100); 2020 (N=121); 2021 (N=84); 2022 (N=98)

4 Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës “Salih Çeka” duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2018.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit për të diplomuarit e 2022 janë përmbledhur më poshtë:

- 84% e të diplomuarve në 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 98 të anketuarish, 52% ishin të punësuar, 13% të vetëpunësuar, 17% ishin student/kursant, 8% ishin të punësuar por edhe punonin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, 9% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të papunë një vit pas diplomimit.
- 83% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 80% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 63% e të diplomuarve në TIK dhe 20% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 60% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 30% e të diplomuarve në TIK vijojnë studime të mëtejshme.
- 69% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, ndërsa 31% u shprehën që nuk lidhet. Nga viti 2018-2021, mesatarisht 69% e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe 31% se puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit. Ndërkohë, të disagreguara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 100% e të diplomuarve të gjinisë femërore dhe 67% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore punojnë në profesion.
- Përqindja e të diplomuarve që janë shprehur se i përdorin njohuritë në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë” për vitin 2022 është 60%. Këtu vërehet një rritje me 1 pikë përqindje në karhasim me mesataren e viteve 2018-2021.
- Për vitin 2022, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 6% paga minimale – 35,000 lekë, 17% në fashën 35,001 – 50,000 lekë, 25% në fashën 50,001 – 65,000 lekë, 19% në fashën 65,001 – 80,000 lekë. Ndërkohë, 33% paguhen më shumë se 80,001 lekë. Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve vërehet se 3% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 18% e të diplomuarve në TIK paguhen më pak 35,000 lekë. Ndërkohë, 11% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 13% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 35% e të diplomuarve në TIK paguhen mes 35,001 dhe 50,000 lekë. Gjithashtu, 100% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 29% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 19% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 18% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë 50,001 - 65,000 lekë. Nga ana tjetër, vetëm 26% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 25% e të diplomuarve në Termohidraulikë paguhen 65,001 – 80,000 lekë. Ndërkohë, 32% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 44% e të diplomuarve në Termohidraulikë dhe 29% e të diplomuarve në TIK paguhen më shumë se 80,001 lekë.
- 75% e të gjurmuarve janë punësuar para se të diplomohen. Kjo shënon një rritje me 13 pikë përqindje në raport me mesataren 2018-2021 ku vetëm 62% e të diplomuarve gjenin një punë para se të diplomoheshin. Ndërkohë, 3% janë punësuar një muaj pas diplomimit, 12% deri në tre muaj pas diplomimit dhe 3% gjashtë deri në nëntë muaj pas diplomimit.
- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen të sigurt dhe të kënaqur në punën e tyre aktuale, ku rreth 83% e tyre janë përgjigjur “të sigurt/shumë të sigurt” dhe 79% “të kënaqur ose shumë të kënaqur”. Vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 9%. Në numër absolut kjo shkon në 9 të papunë. Të pyetur nëse po kërkojnë për një mundësi punësimi, 6 prej tyre (67%) janë përgjigjur po.
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Përkatësisht bashkëpunimit me zyrat e punësimit (57%), përmirësimi i kurrikulave (47%), tekstet dhe materialet (46%), bashkëpunimi me bizneset (45%) dhe këshillimi i karrierës (42%) kanë nevojë për “shumë/jashtëzakonisht shumë” përmirësim.
- Brenda dy viteve të ardhshme, 38% e të diplomuarve në vitin 2022 shpresojnë të kenë filluar biznesin e tyre, 36% të emigrojnë jashtë vendit, 28% të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit.

- Aspiratat për sipërmarrje për vitin 2022 kanë shënuar një rritje me 6 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (32%).